

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “ HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
PROGRAMI: SHKENCAT E USHQIMIT



PUNIM DIPLOME
(Studimet Master)

TITULLI I TEMËS:

“ Përceptimi i publikut mbi teknologjitë ushqimore”

Mentori:

Prof. Assoc. Dr. Arbenita Hasani

Punoi:

Brikena Hulaj Krasniqi

Prishtinë, Nëntor 2023

Përmbledhje

Duke pasur parasysh trendin e madh të rritjes së popullsisë në Botë problematika e sigurimit të ushqimit për këtë numër në rritje të banorëve paraqet një nga sfidat më të mëdha të hulumtuesëve dhe shkencëtarëve për të zbuluar dhe avancuar teknika të reja për prodhimin e ushqimit me teknologjitë e reja të cilat do të ndikonin në uljen e shkallës së urisë dhe rritjen e sigurisë së përdorimit të këtyre produkteve ushqimore dhe rritjen e vlerave ushqyese të produkteve. Motivi për të studiuar dhe analizuar perceptimin e publikut mbi teknologjitë e reja ushqimore vjen si pasojë e refuzimit të vazhdueshëm të qytetarëve për t'i përdorur produktet e prodhuara nga këto teknologji duke i cilësuar ato si të rrezikshme.

Ky punim hulumtues bazohet në rezultatet e arritura nga pyetësorët të shpërndarë në disa grupmosha të popullsisë në vendin tonë duke filluar nga mosha 16 vjeçare deri në grupmoshat mbi 60 vjeç. Nga 300 mostra përfaqësuese të moshave të ndryshme dhe gjinive të ndryshme janë fituar këto rezultate në bazë të njohurive të konsumatorëve mbi teknologjitë e reja ushqimore dhe faktet se do i pranonin këto teknologji për prodhimin e produkteve ushqimore.

Ndonëse pyetësi ka qenë i qasshëm për të gjitha grupmoshat në këtë pyetësor përqindja më e madhe 34.66% e tyre u takon grupmoshës 19-29 vjeç, të pasuar nga grupmosha 45-60 vjeç me 22.66%. Konsumatorët e përgjigjur në pyetësor në një përqindje më të madhe (22.66% respektivisht 31.3%) janë shprehur se kanë njohuri mesatare apo të pakta për teknologjitë e reja të prodhimit të cilat kanë marr një hov zhvillimi në këtë kohë. Si rezultat i mosnjohjes së këtyre teknologjive të reja në këtë pyetësor konsumatorët janë deklaruar se nuk i përdorin dhe i shmangin ushqimet e prodhuara si rezultat i këtyre teknologjive duke i cilësuar ato si të panatyrshme. Duke qenë të kujdesshëm dhe të frikësuar për shëndetin e tyre dhe cilësinë e ushqimeve të tyre konsumatorët në përqindje më të madhe 39.66% janë deklaruar se do të paguanin më shtrenjtë nëse kjo do tu garantonte atyre siguri dhe rritje të cilësisë së ushqimeve që ata i konsumojnë ndërsa 3.33% nuk pajtohen fare me këtë mendim. Sa i përket përdorimit të aditivëve në ushqim konsumatorët në përqindje më të madhe 27.33% janë deklaruar se i shohin aditivët si të nevojshëm dhe të sigurt nëse përdorimi i tyre bëhet në sasinë e duhur. Numri më i madh i konsumatorëve 47% gjithashtu është përgjigjur se i besojnë plotësisht qeverisë dhe pajtohen me rolin e saj në sigurinë e ushqimit të tyre. Teknologjitë e reja ushqimore me një mesatare është vërejtur se 26.59% e

konsumatorëve nuk do t'i përdornin me vetëdije, 25.73% i perceptojnë si të panatyrshme ndërsa 13.73% i konsiderojnë si të rrezikshme për shëndetin.

Duke ditur gjithashtu problematikën e perceptimit të konsumatorëve sa u përket teknologjive të reja ushqimore që synohet të kenë vend të posaçëm në tryezën e konsumatorit duhet të ndiqen shumë hapa në mënyrë që konsumatori të vijë më lehtë te informatat mbi produktin dhe mënyrën se si ky produkt është formuar duke qenë kompania transparente me konsumatorin sa i përket teknologjive ushqimore të përdorura.

Si një propozim për pranimin më të lehtë apo përdorimin e këtyre produkteve nga konsumatori është përgatitja e një fushate sensibilizuese me anë të cilës konsumatorët mund të marrin informacionet e nevojshme mbi mënyrën e prodhimit të një produkti ushqimor duke i përdorur këto teknologji duke përfshirë këtu dhe përparësitë që na i ofron ai produkt ushqimor mirëpo duke mos mënjanuar edhe efektet negative të atij ushqimi në organizëm.

Fjalët kyçe: Teknologjitë e reja ushqimore, konsumatori, pranimi, refuzimi

Summary

Given the great trend of population growth in the world, the problem of providing food for this growing number of inhabitants represents one of the biggest challenges for researchers and scientists to discover and advance new techniques for food production with the technologies of new ones which would affect the reduction of the hunger rate and increase the safety of the use of these food products and increase the nutritional value of the products. The motive to study and analyze the public's perception on new food technologies comes as a result of the continuous refusal of citizens to use the products produced by these technologies, describing them as dangerous.

This research paper is based on the results obtained from the questionnaires distributed to several age groups of the population in our country, starting from the age of 16 years to the age groups over 60 years old. From 300 representative samples of different ages and different genders, these results were obtained based on consumers' knowledge of new food technologies and the fact that they would accept these technologies for the production of food products.

Although the questionnaire was accessible to all age groups in this questionnaire, the largest percentage of them 34.66% belong to the 19-29 age group, followed by the 45-60 age group with 22.66%. The consumers who answered the questionnaire in a larger percentage (22.66% and 31.3% respectively) expressed that they have average or little knowledge about the new production technologies that have taken a development spurt at this time. As a result of not knowing these new technologies, in this questionnaire consumers have stated that they do not use and avoid foods produced as a result of these technologies, describing them as unnatural. Being careful and afraid for their health and the quality of their food, consumers in a larger percentage 39.66% have declared that they would pay more if this would guarantee them safety and increase the quality of the food they consume while 3.33% do not agree with this opinion at all. Regarding the use of additives in food, consumers in a larger percentage, 27.33%, have declared that they see additives as necessary and safe if they are used in the right amount. The largest number of consumers 47% also responded that they fully trust the government and agree with its role in the safety of their food.

New food technologies with an average of 26.59% of consumers would not use them consciously, 25.73% perceive them as unnatural while 13.73% consider them as dangerous to health. Also knowing the problem of consumer perception regarding new food technologies that are intended to have a special place on the consumer's table, many steps must be followed so that the consumer can more easily access information on the product and how this product is formed by being a transparent company with the consumer regarding the food technologies used.

As a proposal for the easier acceptance or use of these products by the consumer is the preparation of an awareness campaign through which consumers can receive the necessary information on how to produce a food product using these technologies, including the advantages that that food product offers us, while not avoiding the negative effects of that food on the body.

Key words: New food technologies, consumer, acceptance, rejection.